



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

VENDIM

PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E BASHKIVE TË DEPOZITUARA NGA PARTIA SOCIALISTE E MODERUAR, PJESËTARE E KOALICIONIT "ALEANCA PËR SHQIPËRINË EUROPIANE", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 22.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për pranimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkive: Shkodër, Tiranë, Lezhë, Korçë, Durrës, të paraqitura nga Partia Socialiste e Moderuar pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia Socialiste e Moderuar, si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Partia Socialiste e Moderuar, me vendimin e KQZ-së nr. 38, datë 11.03.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019. Me vendimin e KQZ-së nr.251, datë 07.05.2019, është regjistruar koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", pjesë e të cilit është dhe Partia Socialiste e Moderuar.



Nr. 625 i Vendimit

Data 22.05.2019

Ora 17:00 e Vendimit

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga Partia "Socialiste e Moderuar", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ka depozituar në KQZ listën shumëmemërore të kandidatëve të saj për anëtarë në Këshillin e Bashkive: Shkodër, Tiranë, Lezhë, Korçë, Durrës. KQZ, ka vendosur kthimin për plotësim të listës shumëmemërore të kandidatëve për këshillin e bashkisë:

- Durrës me vendimin nr. 433 datë 16.05.2019.

Brenda afatit Partia Socialiste e Moderuar, ka plotësuar dokumentacionin sipas vendimit të KQZ-së për Bashkinë Durrës.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetarë apo për këshillin e bashkive: Shkodër, Tiranë, Lezhë, Korçë, Durrës; pasi bashkitë Shkodër, Tiranë, Lezhë, Korçë, Durrës administrohen nga më shumë se një KZAZ.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë:

1. Listat shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkive Shkodër, Tiranë, Lezhë, Korçë, Durrës;
2. Deklaratat e kandidatëve të listave shumëmemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për anëtar këshilli në Këshillin e Bashkive: Shkodër, Tiranë, Lezhë, Korçë, Durrës, të propozuar nga Partia Socialiste e Moderuar;
3. Kopje të dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët e listave shumëmemërore;
4. Vërtetim i Kuvendit të Shqipërisë, nr. 1851/1. prot., datë 09.05.2019, sipas të cilit vërtetohet se Partia Socialiste, përfaqësohet nga 74 deputetë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë;
5. Jetëshkrimin për të gjithë kandidatët e listës shumëmemërore;
6. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";
7. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit;

Në mbledhjen e datës 22.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumëmemërore të kandidatëve për këshillin e Bashkive Shkodër, Tiranë, Lezhë, Korçë, Durrës të Partisë Socialiste e Moderuar dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi se është në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 67, pika 2, 4, 5 dhe 6 dhe neni 72 të Kodit Zgjedhor.

Në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumëmemërore. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në Këshillat Bashkiak Shkodër, Tiranë, Lezhë, Korçë, Durrës që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nga ku rezultoi se:

Lista shumëmemërore e Bashkisë Durrës:

1. Kandidati me numër **rendor 7, z. Spiro Llambi Bojaxhiu**, në bazë të vendimit nr. 602 datë 24.11.2006 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës e ka deklaruar fajtor për veprën



Nr. 625 i Vendimit

Data 22.05.2019

Ora 17:00 e Vendimit

Për miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga Partia "Socialiste e Moderuar", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

penale të "Mashtimit" në bazë të nenit 143/1 të K.P është denuar me 500.000 lekë gjobë për falsifikimin e formularëve, vulave ose stampave, në bazë të nenit 190/1 të K.P është denuar me 300.000 lekë gjobë. Në bazë të nenit 55 të K.P dhe nenit 406 K.Pr.P është denuar me 400.000 lekë gjobë.

Në bazë të nenit 69 Kodit Penal është rehabilituar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstaton se për personat e shënuar në listën shumëmemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkive: Shkodër, Tiranë, Lezhë, Korçë, Durrës të Partisë Socialiste e Moderuar pjesëtare të Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 625 i Vendimit

Data 22.05.2019

Ora 17:00 e Vendimit

Për miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga Partia "Socialiste e Moderuar", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019